REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 FAZA I, shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë, datë. 26.06.2025.

Analiza ligjore:

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015"per veteqeverisjen Vendore", neni 9 pika c dhe ç, neni 54 germa ç dhe dh, Ligji 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.68 date 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjit 9632 date 30.10.2006, "Per sistemin e taksave vendore", Ligji 9975 date 2.07.2008,"Per taksat kombetare" i ndryshuar, *UMF nr.7, date 25.02.2022" Per nje ndryshim ne Udhezimin nr.23, date 30.07.2018"Per procedurat standarte te pregatitjes se Programit Buxhetor Afatmesem te njesive te veteqeverisjes vendore",* Udhezimin nr 8 date 28.02.2025, "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028", si edhe Rregullores së funksionimit të këshillit bashkiak, Sarandë.

Situata aktuale e funksionit:

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare. Ne Programin Buxhetor Afatmesem(PBA) perfshihen:

1. Aparati i Bashkise Sarande
2. Njesite e Varesise

PBA-ja eshte hartuar ne baze te funksioneve, ku cdo funksion ledhet me disa programe te pushtetit vendor, brenda te cilave jane perfshire nje ose me shume Njesi Shpenzuese, ne perputhje me funksionet dhe qellimet perkatese per cdo njesi. Per cdo program jane parashikuar te gjitha shpenzimet qe do te sherbejne per realizimin e objektivave te tij, sipas lloit dhe Njesive Shpenzuese.

Shpenzimet e buxhetit te Bashkise Sarande sipas natyres jane:

a. Shpenzime personeli
b. Shpenzime operative
c. Shpenzime kapitale
d. Fondi Rezerve dhe kontigjences

Situata financiare:

Situata financiare paraqitet sipas tabelave bashkëlidhur.

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Drejtoria Ekonomike.

Impakti social/grupet qe preken:

Të gjithë qytetarët e bashkisë së Sarandës dhe vizitorë të huaj në këtë bashki.

A është objekt i konsultimit publik?

Është objekt i konsultimit publik.

Komisioni i përhershëm për Ekonominë dhe Financën, i mbledhur më datë 26.06.2025, shqyrtoi projektvendimin, si edhe relacionin dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit Bashkiak:

a- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:

Të miratohet drafti i parë i PBA-së i cili përcillet ne Ministrinë e Financave dhe menjëherë dokumenti t`i nënshtrohet procesit të konsultimit publik. Sugjerimet e marra nga komuniteti si edhe komentet e Ministrisë të reflektohen ne draftin final, i cili do të sillet sërish në këshillin bashkiak për miratim.

Pranvera Osmani **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Ilir Gërdhuqi **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Eugen Qëndro **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Gjergji Imeraj **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)